



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 33.2, shkronja a dhe nenit 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinas, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.04.2017, merr këtë

V E N D I M

- I. **ANULOHET** Rirregullimi i kufijve të ngastrave kadastrale sipas Planit rregullues "Lakërishta", i bërë sipas marrëveshjes nr. 010 - 465 - 23306, dt. 24.07.2012.
- II. Anulimi i marrëveshjes në kuptim të pikës I të këtij vendimi, vjen për shkak të ndryshimit të rrethanave faktike në terren pas miratimit të Vendimit të Kuvendit të Komunës 01 - nr. 031-52761, dt. 04.03.2016, për ndryshimin - përshtatjen e profilit të rrugës "F - F" ndërmjet blloqeve "B 1" dhe "B 2" në lagjen "Lakërishta" në Prishtinë, të cilat e kanë bërë të pamundur realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshjeje.
- III. Autorizohet drejtori i Drejtorisë së Pronës që të nënshkruajë zgjidhjen e Marrëveshjes nr. 010-465-23306, dt. 24.07.2012 për rirregullimin e kufijve të ngastrave kadastrale sipas Planit rregullues "Lakërishta".
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01-350/01-0093775/17, më 24.04.2017



KRYESUESI I KUVENDIT

Halim Halimi, jur. i dpl.